



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 2/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevc, anëtarë dhe me zyrtarin e lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. protokolli 919/2019 të datës 04.09.2019 lidhur me mos emërimin e anëtarëve të këtij subjekti politik në Komisionet Komunale Zgjedhor (KKZ) në komunën e Istogut, Lipjanit, Obiliqit, Pejës, Skenderaj, Vitisë, Vushtrrisë dhe Klinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. protokolli 919/2019 të datës 04.09.2019, lidhur me mos emërimin e anëtarëve të këtij subjekti politik në Komisionet Komunale Zgjedhor (KKZ) në komunën e Istogut, Lipjanit, Obiliqit, Pejës, Skenderaj, Vitisë, Vushtrrisë dhe Klinës.

## A r s y e t i m

**PZAP-i**, ka pranuar një apel nga përfaqësuesi i subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), paraqitur kundër vendimit me numër protokolli 919/2019 datë 04.09.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) ka propozuar anëtarët për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) për 24 komuna, ku në 8 komuna si në Istog, Lipjan, Obiliq, Pejë, Skenderaj, Viti, Vushtrri dhe Klinë nuk janë certifikuar anëtarët e tyre nga ana e KQZ-së. Më tutje parashtruesi i apelit thekson se në komunën e Klinës është emëruar Trajko Prođović nga SLS, e jo Milorad Šarković siç është shënuar në vendimin e KQZ-së nr.919/2019.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ theksohet se KQZ gjatë emërimit të KKZ-ve është bazuar në nenin 67 të LZP-së, ku në rastin konkret tek nominimet e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), KQZ-ja është bazuar në nenin 67 paragrafi 3 dhe nenin 67 paragrafi 9 të këtij ligj, ku në momentin e emërimit ka marrë për bazë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli ka gjetur se përveç pretendimeve të thëna si më lartë, pala parashtruese nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e parashtruara në apel. Paneli vlerëson se, pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit Nr. 919/2019 të datës 04.09.2019 nga KQZ-ja për nominimin e anëtarëve për KKZ në 8 komuna të Kosovës i është bërë e padrejte janë të paqëndrueshme ngase KQZ me rastin e nominimeve të anëtarëve të KKZ-ve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06.10.2019 si kriter ka marrë për bazë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha subjektet politike si dhe për gjitha komunitetet brenda një komune. Lidhur me pretendimet e se ne komunën e Klinës është emëruar Trajko Prodroviq nga SLS-ja e jo Milorad Sharkoviq , është pretendim i paqëndrueshëm sepse me vendimin e ankimuar të KQZ-se është emëruar Milorad Sharkoviq nga Lista Serbe por ne vendimin e ankimuar është bërë gabim sa i përket akronimit të subjektit ku ne vend të SLS duhet et jete Lista Serbe të cilin gabim e ka rregulluar KQZ-ja sipas tabelës për nominimet për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve në Komunën e Klinës që gjenden në shkresat e lëndës.

Mbi këtë bazë Paneli vlerëson se vendimi i apeluar i KQZ-së, për nominimin e kandidatëve të KKZ-së për komunat e lartcekura si në apel, është i bazuar në ligj dhe është në harmoni të plotë me nenin 67 par. 1 dhe 3 të LZP-se në të cilin KQZ-ja është përpjekur dhe ka garantuar përfaqësimin e drejtë dhe në mënyrë proporcionale të KKZ-ve në komunat e theksuar më lart për të gjitha komunitetet me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 2/2019 më datën 10.09.2019.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*